VENDIM
Nr.720, datë 14.5.2008

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS "BOT" TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË "SIGERS" SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT "MARTANESH "

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë "Sigers" sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit "Martanesh", sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha